

VENDIM
Nr. 4, datë 29.2.2012

PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORISË SË KONSUMATORËVE PËR DISA KLIENTË TË
VEÇANTË

Në zbatim nenit 14 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, vendimit nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve sh.a.” dhe Metodologjisë për Vendosjen e Tarifave, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të përcaktojë kategorinë e konsumatorëve sipas përkatësisë, për disa konsumatorë të veçantë, si më poshtë:

a) Trupat diplomatikë (ambasada, konsullata dhe rezidenca diplomatike) të trajtohen në kategorinë “ent publik”.

b) Komunitetet fetare (selitë e tyre dhe objektet e kultit si kisha, xhami etj.) të trajtohen në kategorinë “ent publik”. Këtu bëjnë përjashtim ato institucione e struktura të krijuara nga këto komunitete të cilat ushtrojnë veprimtari arsimore, shëndetësore e ekonomike, të cilat duhet të trajtohen në kategorinë “ent privat”.

c) Partitë politike (selitë dhe degët e tyre në qytete) të trajtohen si “Ent publik”;

d) Shoqëritë tregtare shtetërore (KESH sh.a., ndërmarrjet e trajtimit të studentëve, dhe çdo shoqëri tjetër shtetërore) të trajtohen si “ent privat”.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Avni Dervishi